



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	27-03-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtupj e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHKK	3026/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.424/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.424/2023 të datës 27.02.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë fshati Buçë, në Komunën e Dragashit, kundër Vendimit me numër 02 Nr.112/01-1804/23 të datës 19.01.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Dragashit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.424/2023 e datës 27.02.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Komuna e Dragashit më datë 14.09.2022 ka njoftuar për shpalljen e Konkursit me Nr. Reference: RN00009936 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për Mbrojtje të Mjedisit", me afati aplikimin prej datës 29.09.2022 deri më datë 06.10.2022. Në këtë pozitë ka aplikuar edhe ankuesi i cili ka marr pjesë në fazën e intervistës me gojë, ku rezultoi se mbi bazën e njoftimit të datës 19.03.2023 për vlerësimin e rezultatit përfundimtar ankuesi është vlerësuar me gjithsej 35.8 pikë.

Ankuesi kundër vlerësimit të rezultatit përfundimtar të datës 19.12.2022, më datë 27.10.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Vlerësim për Lëvizje Brenda Kategorisë, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me numër 02 Nr.112/01-1804/23 të datës 19.01.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit ndërsa ka lënë në fuqi vlerësimin e komisionit.



Ankuesi kundër Vendimit me numër 02 Nr.112/01-1804/23 të datës 19.01.2023, më datë 23.02.2023 përmes postës ka dorëzuar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 27.02.2023 dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.424/2023 dhe me numër protokolli 2131/2023.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën e ankuesit me numër protokolli 2131/2023 të datës 27.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 02 Nr.112/01-1804/23 të datës 19.01.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Dragashit; Ankesën e datës 27.11.2022 e parashtruar nga ankuesi; Njoftimin e datës 19.12.2022 për vlerësim përfundimtar; Njoftimin e datës 02.12.2022 për ankuesin për intervistë me gojë; Vendimin e datës 14.11.2022 për verifikim paraprak; Dokument identifikimin për ankuesin; Zarin e datës 23.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.03.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 16.03.2023; Fletë kthesën për ankuesin e datës 19.01.2023; Dëshmi për pranim me nënshkrim e datës 23.01.2023; Njoftim e datës 09.03.2023; Konkursin me Nr. Reference: RN00009936 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për Mbrojtjen të Mjedisit", të shpallur nga Komuna e Dragashit; Listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve; Aplikacionin e ankuesi i datës 04.10.2022; Diplomën e datës 28.10.2015; Vendimin e datës 29.08.2017 të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Kontratë Pune e datës 29.06.2015; Akt Emërimit e datë 30.03.2018, 04.02.2016; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 06.02.2017; Vërtetimin e datës 03.10.2022; Formularin për vlerësimin të rezultateve në punë i datës 21.01.2021, 20.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar, *sepse:*

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, konstaton se Komuna e Dragashit më datë 19.01.2023 përmes postes së Dragashit, ankuesi i ka dërguar Vendimin me numër 02 Nr.112/01-1804/23 i datës 19.01.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Dragashit, ndërsa në bazë të dëshmisë për marrjen e dokumentit nga posta më datë 23.01.2023 vendimi i lartcekur është pranuar nga gruaja e ankuesit znj.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, konstaton se sipas dispozitave të nenit 81 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative lidhur me llogaritja e afateve, është përcaktuar se: "1. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, afatet do të përcaktohen në ditë, muaj apo vite. Mbarimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike. 2. Kur afati përcaktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja nga e cila fillon të ecën afati...", si rrjedhojë meqë vendimi i kontestuar është pranuar më datë 23.01.2023, atëherë afati për ankim ndaj këtij vendimi ankuesit i ka rrjedh nga data 24.01.2023, ndërsa ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 02 Nr.112/01-1804/23 të datës 19.01.2023, e ka dorëzuar përmes postës më 23.02.2023.

Nga të cekurat si më lartë, Kolegji i Këshillit, duke bërë llogaritjen e afatit prej datës 24.01.2023 deri më datë 23.02.2023, konstaton se dita e 30 ka qenë data 22.02.2023, rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit është parashtruar më datë 23.02.2023 është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme





Administrative, i cili shprehimisht përcakton: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ".

Andaj, nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që ankesa e ankuesit të hedhet poshtë si e palejuar.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.424/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

